



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Planuar / Dërguar Bashkëpunues/Prodator E. cësuesit/Delivry	16-09-2022	2	viti god veçr
Organ Bëse Organ Jedinec Org. Tit	Dr. Prof. Dr. Prof. Prof. No	Shtesa Punog Appendix	Sasia Kohëzma Quantity
SKPM/SHK	5466/2022		1/7



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.636/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Jeton Koca-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.636/2022 të datës 20.07.2022, të parashtruar nga ankuesi [redacted] me adresë banimi [redacted] në Komunën e Prishtinës, ankesën A.nr.631/2022 të datës 18.07.2022 e parashtruar nga ankuesja [redacted] dhe ankesën A.nr.617/2022 të datës 14.07.2022 e parashtruar nga ankuesi [redacted] ku këta dy të fundit me autorizim i përfaqëson Avokati [redacted] me adresë: [redacted] kundër Vendimit me numër Ref:31/2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit të Aviacionit Civil i datës 22.06.2022, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 16.09.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa A.nr.636/2022 e datës 20.07.2022 e parashtruar nga ankuesi [redacted] ankesa A.nr.631/2022 e datës 18.07.2022 e parashtruar nga ankuesja [redacted] dhe ankesa A.nr.617/2022 e datës 14.07.2022 e parashtruar nga ankuesi [redacted]
- II. Shfuqizohet Vendimit me numër Ref:31/2022 i Drejtorit të Përgjithshëm në Autoritetin e Aviacionit Civil të Kosovës i datës 22.06.2022.
- III. Obligohet Drejtorit i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të tij.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.

A r s y e t i m

Ankuesit, dhe sipas shkresave të lëndës të punësuar në Autoritetin e Aviacionit Civil, kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër Ref:31/2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit të Aviacionit Civil i datës 22.06.2022 me pretendimet ankimore se i njëjti vendim është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat e Ligjit nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative; Ligjit Nr.03/L-051 për Aviacionin Civil, Rregullores Nr.08/2011 për Autorizimet dhe Kredencialet e Inspektorëve, Udhëzimit Administrativ Nr.02/2011 për Procedurat e Lëshimit të Kredencialeve të Inspektorit si dhe në kundërshtim edhe me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka proceduar kërkesat me numër për përgjigje në ankesat e ankuesve tek Autoriteti i Aviacionit Civil, ndërsa me datë 26.07.2022, 02.08.2022 si dhe 08.08.2022 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga ky institucion së bashku me provat e lëndës.

Bazuar në kërkesën e Kryetarit të Kolegjit të datës 09.09.2022 për bashkimin e ankesës A.nr.631/2022 të datës 18.07.2022 e parashtruar nga ankuesja dhe ankesa A.nr.631/2022 të datës 14.07.2022 e parashtruar nga ankuesi me ankesën A.nr.636/2022 të datës 20.07.2022 e parashtruar nga ankuesi ka vendosur me datën 12.09.2022 dhe ka nxjerrë Vendimin me numër VK.Nr.93/2022 përmes të cilit i ka bashkuar ankesat e ankuesve në ankesën e fundit me numër A.nr.636/2022, pasi që baza ligjore dhe objekti i shqyrtimit gjegjësisht akt i kontestuar janë të njëjta.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave për vendosje meritore ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 4210/2022 të datës 20.07.2022 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës me e-mailin e bashkangjitur të datës 20.07.2022 dërguar nga ankuesja në Këshill; Vendimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës me numër ref:31/2022 i datës 22.06.2022; Raportin e Auditimit të datës 24.12.2021; Manualin e Departamentit të Bashkëpunimit Ndërkombëtar dhe Rregullimit Ekonomik të Aviacionit i datës 15.03.2018; Shkresën "Shtojca 1-Proceset"; Shkresën "Mbikëqyrja Ekonomike e aeroporteve dhe shërbyesve në tokë" e datës 15.03.2018; Shkresën "Miratimi i tarifave të SHNA-së" të datës 15.03.2018; Shkresën "Marrëdhëniet me organizatat ndërqeveritare të aviacionit" të datës 13.06.2017; Shkresën "Monitorimi i zbatimit të Marrëveshjeve për HPEA në Kosovë" të datës 13.06.2017; Shkresën "Raportimi mbi Integritet Evropiane"; Shkresën "Koordinimi i asistencës teknike" të datës 13.06.2017; Shkresën "Pranimi i të dhënave statistikore" të datës 15.03.2018; Shkresën "Buletini i AACK-së" të datës 13.06.2017; Shkresën "Miratimi i tarifave aeroportuale" të datës 15.03.2018; Shkresën "Shtojcë 2-Formularët"; Shkresën "Analiza Financiare e Aeroportit" të datës 13.06.2017; Shkresën "Formular për raportim të transportit ajror" të datës 28.02.2018; Shkresën "Formular për Raportimin e Njesisë Terminal" të datës 20.03.2019; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 28.07.2022; E-mailin e datës 01.08.2022 me shkresat e dërguara të lëndës i protokolluar me numër:4466/2022; Udhëzimin Administrativ Nr.2/2011 për Procedurat e Lëshimit të Kredencialeve të Inspektorit; Shkresën "Shtojca 1-Aplikacioni për Kredenciale të Inspektorit"; Shkresën "Shtojca 2-Formular vlerësimi për inspektor"; Rregulloren Nr.08/2011 për Autorizimet

dhe Kredencialet e Inspektorëve; Shkresën "Shtojcën 1 të kartelës së kredencialeve të inspektorit"; Udhëzimin Administrativ Nr.01/2020 për Ndryshimin dhe Plotësimin e udhëzimit Administrativ Nr.02/2011; Përgjigjen e datës 01.08.2022; E-mailin e datës 15.03.2021 dërguar nga S.S për L.A me korrespondencën e bashkangjitur; E-mailin e datës 15.03.2021 dërguar nga A.K për S.S me korrespondencën e bashkangjitur; Akt emërimit e datës 01.05.2013 me përshkrimin e detyrave të punës së ankuesit; Shkresën e datës 27.12.2017 për aprovimin e kredencialeve; Rekomandimin e datës 26.12.2017 me dosjen e bashkangjitur; Shkresën "Vazhdimi i kartelës së kredencialeve të Inspektorit" i datës 22.01.2022; Vendimin e Këshillit të datës 26.12.2014; Raportin Mbikëqyrjes së Zbatimit të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil i vitit 2014; Raportin e punës së ankuesit i datës 19.04.2022; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Drejtor i Bashkëpunimit Ndërkombëtar dhe Rregullimit Ekonomik të Aviacionit; Shkresën "Listë kontrolli"; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Zyrtar i lartë për bashkëpunim profesional ndërkombëtar; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Zyrtar për rregullimin ekonomik të aeroporteve dhe shërbimeve të navigacionit ajror; Vendimin me numër VK.nr.87-1/2022 të datës 02.09.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ankesën me numër të protokollit 5173/2022 të datës 18.07.2022 të parashtruar nga ankuesja [redacted] në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Autorizimin e datës 29.06.2022 nga përfaqësuesi ligjor i ankueses; Shkresën zyrtare me numër Ref:AACK/ADM/BNJ-06 të datës 28.12.2012; Kartelën e ankueses me numër CAA-03/2007 të datës 30.05.2022 mbi kredencialet e inspektorit; Shkresën zyrtare me numër Ref:36/DEL/01 të datës 29.11.2007; Shkresën zyrtare të datës 01.10.2007 me numër 17-17 mbi përshkrimin e detyrave të punës; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Inspektor i aerodromeve; Listën me emrat e nëpunësve për pozitat e inspektorëve në ACC; Raportin e punës të datës 13.11.2020 për periudhën një javore të ankueses; Listimin e trajnimeve për ankuesen; Raportin e auditimit me numër të referencës 0222-01 të datës 08.03.2022; E-mailin zyrtar të datës 23.06.2022; E-mailin zyrtar të datës 22.06.2022; Vendimin Nr.Ref:31/2022 të datës 22.06.2022 nga Drejtori i Përgjithshëm i AAC-së; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 21.07.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 26.07.2022 nga Autoriteti i Aviacionit Civil së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Akt emërimit e ankueses të datës 01.08.2018 së bashku me përshkrimin e detyrave të punës; Udhëzimin administrativ (AAC) Nr.01/2020 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr.2/2011; Aplikacionin për kredenciale të inspektorit sipas shtojcës 1 dhe Formularin për vlerësimin për inspektor; Vendimin me numër VK.nr.85/2022 të datës 25.08.2022 lidhur me vazhdimin e afatit të ankesës në Këshill; Konfirmimin e pranimit të vendimit për shtyrje të afatit të ankesës nga ana e avokatit të datës 25.08.2022 përmes e-mailit; Ankesën me numër të protokollit 4095/2022 të datës 14.07.2022 të parashtruar nga ankuesi [redacted] në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Autorizimin e datës 07.07.2022 nga përfaqësuesi ligjor për ankuesin; Akt emërimit e ankuesit të datës 31.12.2012; Shkresën zyrtare me numër AACK/ADM/BNJ-28 të datës 19.12.2018 lidhur me autorizimin për Inspektor të akredituar të operimeve për helikopter për ankuesin nga Drejtori i Përgjithshëm i ACC-së; Vendimin me numër Vendimin Nr.Ref:31/2022 të datës 22.06.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit të Aviacionit Civil; E-mailin e datës 07.07.2022; E-mailin zyrtar të datës 23.06.2022; E-mailin zyrtar të datës 28.07.2021; Kopjen e kartelës së inspektorit të ankuesit; Shkresa me numër CAA-17/2018 e datës 30.05.2022 lidhur me kredencialet e inspektorit për ankuesin; Raportin javor të punës së ankuesit e datës 20.04.2021; Raportin javor të punës së ankuesit të datës 07.06.2021; Raportin javor të punës së

ankuesit të datës 01.02.2021; Raportin javor të punës së ankuesit të datës 19.04.2022; Raportin javor të punës së ankuesit të datës 08.02.2021; Raportin javor të punës së ankuesit të datës 21.12.2020; Raportin javor të punës së ankuesit të datës 08.03.2021; Raportin javor të punës së ankuesit të datës 07.06.2021; Letër përcjellëse të datës 25.07.2021 me numër AACKDSFINHLS-2021-02; Kërkesën për nënshkrim të lejes për operim të datës 12.10.2021 me numër AACKDSFGAT-2021-47; Kërkesën për nënshkrim të lejes për operim të datës 25.05.2022 me numër AACKDSFGAT-2022-05; Kërkesën për nënshkrim të lejes për fluturim të datës 03.02.2022 me numër AACKDSFGAT-2022-01; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 18.07.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 08.08.2022 nga Autoriteti i Aviacionit Civil së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës; E-mailat zyrtar të datës 03.08.2022; Vendimin me numër Ref.nr.29/212 të datës 27.11.2012 nga Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil; Kërkesën e ankuesit të datës 22.03.2021 për Drejtorin e Përgjithshëm të ACC-së; Vendimin me numër A.nr.24/2021 të datës 01.03.2021 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mailat zyrtar të datës 09.03.2021, 11.03.2021, 10.03.2021, 15.03.2021; Vendimin me numër VK.nr.84/2022 të datës 23.08.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër VK.nr.94/2022 të datës 12.09.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesat e ankuesve [redacted] dhe [redacted] janë të bazuar, sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në shkresat e lëndës ka konstatuar se ankuesi [redacted] sipas akt emërimit të datës 30.04.2013 është i punësuar në Autoritetin e Aviacionit Civil të Kosovës në pozitën e punës "Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Ndërkombëtar", ndërsa sipas Rekomandimit të datës 26.12.2017 dhe aprovimit përmes shkresës së datës 27.12.2017 me shifër të referencës: AACK/BNRREA/27 ankuesi është pajisur me kartelën/kredencialet e inspektorit me numër serik:CAA-16/2017, ndërsa sipas rekomandimit të datës 22.01.2020 ankuesit i është vazhduar afati i kartelës së kredencialeve të inspektorit, gjegjësisht sipas shkresave të lëndës kartela e ankuesit me kredenciale të inspektorit ka afat deri me datë 31.12.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në shkresat e lëndës ka konstatuar se ankuesja fillimisht është e punësuar në Autoritetin e Aviacionit Civil, sipas Akt emërimit të datës 01.01.2012 ku ka mbajtur pozitën si "Menaxhere e Auditimit të brendshëm dhe kontrollit të cilësisë" në Zyrën e Auditimit të brendshëm dhe kontroll të cilësisë në këtë institucion. Po ashtu e njëjta me datën 01.08.2018 bazuar në Rregulloren për organizimin dhe funksionimin e brendshëm dhe sistemimin e vendeve të punës është emëruar në pozitën "Drejtore e departamentit për siguri dhe cilësi" në Departamentin për siguri dhe cilësi sipas së cilës mban edhe Akt emërimin AACK/ADM/BNJ/06 të datës 01.08.2018, kurse kredencialet e inspektorit sipas kartelës me shifër të referencës:CAA-03/2007 i ka fituar sipas Letër-delegimit të datës 29.10.2007 dhe letër-delegimit të datës 28.12.2012, ndërsa sipas shkresave të lëndës kartela e ankueses me kredenciale të inspektorit ka afat deri me datë 31.12.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në shkresat e lëndës ka konstatuar se ankuesi është i punësuar në Autoritetin e Aviacionit Civil sipas Akt emërimit të datës 31.12.2012 në pozitën "Zyrtar i operimeve për helikopter" në Departamentin e Sigurisë së Fluturimeve, ndërsa me datën 19.12.2018, përmes shkresës me numër AACK/ADM/BNJ-28, Zëvendës Drejtori i Përgjithshëm në Autoritetin e Aviacionit Civil, kishte lëshuar autorizimin lidhur me marrjen e kredencialeve të Inspektorit të akredituar të operimeve për helikopter, sipas shkresave të lëndës kartela e ankueses me kredenciale të inspektorit e shifër:CAA-17/2018 ka afat deri me datë 31.12.2022.

Po ashtu, në bazë të shkresave të lëndës, Kolegji i Këshillit ka gjetur se Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës me datë 22.06.2022 ka nxjerrë Vendimin me numër Ref:31/2022, përmes të cilit ankuesve të lartë cekur ua ka tërhequr kredencialet e inspektorit për shkak se të njëjtit nuk mbajnë pozita të angazhuar me detyra të mbikëqyrjes, auditimit dhe inspektimit sipas akt emërimit dhe përshkrimit të vendit të punës, me arsyetimin se nëpunësit civil nuk mund të kenë në të njëjtën kohë dy akt emërime sikurse të gjithë inspektorët përveç kushteve të parapara me rregulloren për kredencialet e inspektorëve, duhet që pozitat e tyre t'i kenë në harmoni me përgjegjësitë që i mbajnë sipas akt emërimit.

Me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji i Këshillit ka analizuar dispozitat e Udhëzimit Administrativ Nr.02/2011 për Procedurat e Lëshimit të Kredencialeve të Inspektorit neni 2 ku përcaktohet se: "**Përkufizimet: Kredenciale** – nënkupton: a) Llojin e kualifikimit të veçantë në lidhje me kompetencat e AAC-së, i cili i jep bartësit të saj disa të drejta të caktuara dhe obligime në përputhje me Ligjin Nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil, Rregulloren Nr. 08/2011 për autorizimet dhe kredencialet e inspektorëve dhe këtë Udhëzim Administrativ; dhe/apo; Inspektor – nënkupton një nëpunës të AAC-së, të cilit i është akorduar ky titull pas plotësimit të disa kushteve të nevojshme të cilat janë përcaktuar në Rregulloren Nr. 08/2011 për autorizimet dhe kredencialet e inspektorëve dhe këtij Udhëzimi Administrativ, të cilit i jepet e drejta të kryejë detyra të veçanta mbikëqyrjeje të përcaktuara në Ligjin Nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil dhe në akte nënligjore të lëshuara nga AAC në bazë të tij" dhe po ashtu ka analizuar e dispozitat e Rregullores Nr.08/2011 për Autorizimet dhe Kredencialet e Inspektorëve neni 5 ku përcaktohet se: "**Drejtori i përgjithshëm është autoriteti aprovues për dhënien e kredencialeve. Departamenti i Administratës do të administrojë procesin e lëshimit dhe kontrollit të kredencialeve të lëshuara**" si dhe dispozitat e Manualit të Departamentit të Bashkëpunimit Ndërkombëtar dhe Rregullimit Ekonomik të Aviacionit 2.7 Kualifikimet e Inspektorit: "**Punonjësi i ACC-së që kërkon kredencialet e inspektorit duhet të ketë një kontratë punësimi me një afat fillestar prej jo më pak se një vit, të posedojë diplomë universitare nga fusha ekonomike ose diplomë universitare në ndonjë fushë tjetër**", andaj mbi këtë bazë, Kolegji i Këshillit ka konstatuar se arsyetimi i Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës mbi bazën e të cilit ankuesve u janë tërhequr kredencialet e inspektorit përmes vendimit të datës 22.06.2022 me numër Ref:31/2022, është i paqëndrueshëm dhe në kundërshtim të plotë me dispozitat e akteve të brendshme normative që rregullojnë çështjen e lëshimit të kredencialeve të inspektorit për nëpunësit e AAC-së, pasi që sipas këtyre dispozitave nuk përcaktohet në mënyrë specifike që nëpunësi i AAC-së me qëllim të pajisë me kredencialet e inspektorit duhet të mbajnë pozita të angazhuara mbikëqyrëse, auditimit dhe inspektimit sipas akt emërimeve dhe përshkrimit të detyrave të punës, rrjedhimisht pretendimet ankimore të ankuesve se Vendimi i Drejtorit të Përgjithshëm të ACC-së i datës 22.06.2022 është i kundërligjshëm janë të bazuara.

Ndërlidhur me arsyetimin e dhënë nga Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës në vendimin e datës 22.06.2022 numër Ref:31/2022, i cili kredencialet e inspektorit i barazon më fuqinë e aktit të emërimit, Kolegji i Këshillit vlerëson se janë të paqëndrueshme, ngase akt i emërimit në kuptim të nenit 32 paragrafi 2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë lëshohet me qëllim të themelimit të marrëdhënies së punës në Shërbimin Civil, ndërsa kredencialet e inspektorit në kuptim të nenit 2 të Udhëzimit Administrativ Nr.02/2011 për Procedurat e Lëshimit të Kredencialeve të Inspektorit e kanë kuptimin e dhënies apo njohjes të së drejtës për kryerjen detyrave të veçanta mbikëqyrjeje nën kushtet dhe kriteret e parapara për nëpunësit e AAC-së të cilët veçse e kanë të themeluar marrëdhënien e punës.

Po ashtu, Kolegji i Këshillit ka gjetur se arsyetimi i dhënë në Vendimin me numër: Ref:31/2022 nxjerrë nga Drejtori i Përgjithshëm AAC-së me datë 22.06.2022 në kuptim të nenit 48 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm dhe është i barabartë me mungesën e tij, ngase në asnjë pjesë të arsyetimit të dhënë të vendimit të kontestuar nuk ka arritur të shpjegojë situatën faktike mbi të cilën është marrë vendimi, të përcaktojë shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të rrethanave, nuk ka arritur të përcaktojë qartë bazën ligjore se në cilat raste Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës ka të drejtë t'ia tërheqë kredencialet e inspektorit të cilat i janë njohur apo dhënë një nëpunësi të AAC-së si dhe pse këto dispozita janë të zbatueshme në rastin konkret, andaj në mbështetje të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit konstaton se Vendimi me numër: Ref:31/2022 i nxjerrë nga Drejtori i Përgjithshëm AAC-së me datë 22.06.2022 është i kundërligjshëm.

Kolegji i Këshillit thekson faktin se sipas nenit 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë ankuesi nuk hynë në kategorinë e përjashtimit nga fusha e zbatimit të këtij ligji, andaj Drejtorit të Përgjithshëm në Autoritetin e Aviacionit Civil të Kosovës me rastin e nxjerrjes së Vendimit numër Ref:31/2022 me datë 22.06.2022 përmes të cilit ankuesit ia ka hequr kredencialet e inspektorit, është t'i ketë parasysh dispozitat e ligjit material për shërbimin civil të cilat nëpunësve civil ua garantojnë vazhdimësinë në detyrë siç përcaktohet me nenin 7 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë ku përcaktohet se: *"Menaxhimi i marrëdhënies juridike me nëpunësit civilë, me nëpunësit e Shërbimit Publik dhe me nëpunësit administrativo-teknikë dhe mbështetës, udhëhiqet nga ligji dhe bazohet, gjithashtu, në parimin e mundësive të barabarta, meritës, transparencës, profesionalizmit dhe paanësisë politike, mosdiskriminimit, përfaqësimit të drejtë gjinor dhe të komuniteteve dhe synon garantimin e qëndrueshmërisë dhe vazhdimësisë në detyrë"*.

Andaj, pas shqyrtimit të gjitha shkresave të lëndës të ofruar nga palët në procedurë, pas analizimit të dispozitave të ligjit material dhe akteve normative që rregullojnë çështjen e dhënies së kredencialeve të inspektorit në Autoritetin e Aviacionit Civil të Kosovës si dhe pas konstatimeve të dhëna si në arsyetimin e këtij vendimi, Kolegji i Këshillit në mbështetje të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 dhe 1.5 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: *"Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: 1.4. është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ; 1.5. është në kundërshtim me ligjin material"*, konstaton se Vendimi numër Ref:31/2022 i Drejtorit të Përgjithshëm të AAC-së i datës 22.06.2022, është vendim i paligjshëm pasi është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat e ligjit material, ligjit për procedurën e përgjithshme administrative

dhe akteve të brendshme normative që përcaktojnë kushtet dhe kriteret për dhënien dhe mbajtjen e kredencialeve të inspektorit për nëpunësit e Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës dhe si i tillë është shfuqizuar si në dispozitiv të këtij vendimi, ndërsa pretendimet ankimore të ankuesit janë plotësisht të bazuara në ligj.

Andaj, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe provat e bashkëngjitura nga palët në procedurë, bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe nenit 132 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër: **A.nr.636/2022**

Flakron GASHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- ❖ Ankuesit dhe përfaqësuesit të ankuesve dhe Avokatit
- ❖ Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit të Aviacionit Civil;
- ❖ Udhëheqësit të Personelit në Autoritetin e Aviacionit civil dhe
- ❖ Arkivit të KPMSHCK-së.